



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 58, Datë 12.03.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “WIND POWER ALBANIA” SH.P.K., NË  
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1, gërma “e” dhe neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k licencim në aktivitetin e Tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 164 Prot., datë 07.02.2018, ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE me vendimin nr. 39, datë 23.02.2018, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikim, Transferim, Rinovim ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Wind Power Albania” sh.p.k në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**